



506
29/05/20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 2292 Prot.

Fier, më 26/05/2020

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ

Drejtuar : PREFEKTURËS SË QARKUT - FIER

Në zbatim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në **prefekturën** apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 4, datë 07/04/2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave - “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.6 e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar, njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Komunë, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. Për sa më lart, kërkojmë nga ana Juaj “**Shpalljen Publike**” për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të gjashtë akteve administrativ si vijon :

- Urdhëri i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me Nr. 21005 Prot., datë 16/08/2019, i materializuar nga ana jonë për subjektin “ANASTAS GJATA”, me NIPT K32717419T, me seli në Fier (Lagjja “Apollonia”).

- Urdhëri i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me Nr. 21005 Prot., datë 16/08/2019, i materializuar nga ana jonë për subjektin “KONDAKÇI”, me NIPT K32818402K, me administrator Fedra Kondakçi, me seli në Fier (Lagjja “1 Maji”).


Bashkëngjitur, gjeni kopje Urdhërit të lartpërmendur – gjithsej 1 (një) fletë.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes së lajmërimit publik të vendimeve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Olton Kuqe



MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 9/006 prot.

Nr. 4316 Data 22/08/19

Tiranë, më 16.8.2019

PROTOKOLI

Lënda: Urdhër për kontabilizimin e detyrime të akcizës të transferuara nga DPT

DEGËS DOGANORE FIER

Në zbatim të pikës 9, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 11.03.2019 " Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara";

URDHËROJ

Marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për mbledhjen deri në shuarjen e borxhit në shumën 6.114.580 lekë, përkatësisht sipas subjekteve :

1. ANASTAS GJATA

me NIPT K32717419T

51.367 lekë ✓

4. KONDAKÇI

me NIPT K32818402K

177.260 lekë ✓

Bashkëngjitur dokumentet shoqëruese sipas dosjes Nr.4 të Drejtorisë Rajonale Fier si dhe të dhënat analitike për detyrimet e secilit subjekt.

